



**Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRYSHE**

16 korrik 2015, Prizren

**THIRRJE PËR OFERTË
Realizimi i Hulumtimit**

Realizimi i hulumtimit është aktivitet në kuadër të projektit “Qyteti gjithëpërfshirës – planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren”, që është duke e implementuar nga EC Ma Ndryshe. Ky projekt/aktivitet financohet nga Olof Palme International Center, e cila përkrahet nga Qeveria e Suedisë.

Qëllimi i këtij projekti është të artikulojë nevojat e grupeve të komunitetit dhe t’i përkthejë ato në plane të zbatueshme urbane të komunës së Prizrenit. Grupet e komunitetit me të cilat punohet gjatë këtij viti në këtë projekt janë të shpërndarë në lagje të ndryshme të Prizrenit.

Për nevojat e projektit do të realizohet një hulumtim. Hulumtimi duhet të punohet në përputhje me qëllimin e projektit. Hulumtimi duhet të përfundojë dhe të dorëzohet më së largu deri me 15 shtator 2015.

EC Ma Ndryshe fton kompanitë/konsorciumet e përzgjedhura të dorëzojnë ofertat e tyre për realizimin e hulumtimit. Kompanitë/konsorciumet e interesuara për ofertim duhet të përgatisin projektin ideor (konceptin e hulumtimit, draft pyetësorin, orarin e realizimit) së bashku me ofertën financiare.

Në çmim të ofertës duhet të llogaritet/përfshihet: përgatitja e pyetësorit; shtypi i pyetësorëve (min. 600 copë); trajnimi i intervistuesve; pagesa e intervistuesve; ripërsëritja e anketimit (nëse EC Ma Ndryshe dyshon në mënyrën dhe cilësinë e anketimit); çmimin për një (1) intervistë; transportin, ushqimin dhe komunikimin e intervistuesve; organizimin e grupeve të fokusit; futjen e të dhënave; përgatitjen e statistikave; analizat deskriptive të të dhënave të dala nga intervistat si dhe përgatitjen e raportit cilësor analitik.

Kompanitë e interesuara duhet të jenë profesionale dhe të kenë përvojë në realizimin e hulumtimeve/anketimeve. Ofertat duhet të jenë në 1 original dhe 2 kopje në zarf të mbyllur dhe të dorëzohen në zyrë e EC Ma Ndryshe, Saraçët 5, 20000 Prizren, nga e hëna në të premte, nga ora 09:00- 17:00, jo më vonë se më 29 korrik 2015 si dhe në postën elektronike në info@ecmandryshe.org, me subjekt “Realizimi i Hulumtimit”.

Dokumentacioni i aplikimit duhet të përmbajë edhe: certifikatën e regjistrimit të kompanisë, CV-të e stafit të propozuar, portfolion profesionale (përvojën) dhe dokumente të tjera që dëshmojnë kompetencën profesionale të kompanisë.